



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 02/L-38**

**PËR INSPEKTORATIN SHËNDETËSOR**

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 5.1 (ë) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 datë 15. maj 2001),

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore me pik-synim kujdesin e shëndetit të qytetarëve të Kosovës:

Miraton:

**LIGJIN PËR INSPEKTORATIN SHËNDETËSOR**

Dispozitat themelore

Neni 1

1.1. Inspektorati Shëndetësor (në tekstin e mëtejme Inspektorati) është organ administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë i cili sipas nenit 102.1 të Ligjit të Shëndetësisë ushtron mbikëqyrjen e jashtme profesionale në institucionet shëndetësore.

1.2. Mbikëqyrja profesionale, sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, neni 101.2 siguron zbatimin e normave etike, profesionale dhe të standardeve të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.

1.3. Inspektorati Shëndetësor ushtron mbikëqyrjen e jashtme të veprimtarisë profesionale të institucioneve shëndetësore pa marrë parasysh format e financimit të tyre dhe përkatësinë pronësore.

1.4. Mbikëqyrja e punës së institucioneve shëndetësore nënkupton marrjen e të gjitha masave inspektuese të parapara me këtë ligj me qëllim të arritjes të standardeve përkatëse të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë.

1.5. Ky organ ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe kujdesit ndaj qytetarëve në institucionet shëndetësore.

## Funksionet e Inspektoratit Shëndetësor Neni 2

Funksionet e inspektoratit shëndetësor janë:

1. Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit të shëndetësisë dhe dispozitave të tjera në pajtim me nenin 1.5 që rregullojnë lëmin e shëndetësisë.
2. Siguron këshilla teknike dhe profesionale për veprimtaritë shëndetësore me qëllim të zbatimit të dispozitave dhe standardeve ligjore të parapara me Ligjin e shëndetësisë.
3. Siguron informacione të nevojshme për mënyrën dhe teknikat e arritjes së standardeve përkatëse nga lëmi i shëndetësisë.
4. Njofton Ministrinë e Shëndetësisë, institucionet dhe organet kompetente për punën e paligjshme në institucionet shëndetësore dhe merr masa të parapara me këtë ligj dhe ligjet tjera, në pajtim me autorizimet e dhëna.
5. Siguron informacione, jep ndihmë dhe promovon praktikën më të mirë mjekësore për institucionet shëndetësore.
6. Inspektorati ka për detyrë t'u ofroj institucioneve shëndetësore ndihmë në interpretimin e normave ligjore dhe të akteve tjera nënligjore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë me qëllim të zbatimit efikas të tyre.

## Organizimi i Inspektoratit Shëndetësor Neni 3

- 3.1. Inspektorati Shëndetësor përbëhet nga Kryeinspektori për shëndetësi dhe inspektorët shëndetësor.
- 3.2. Kryeinspektori për shëndetësi dhe inspektorët shëndetësor zgjedhën përmes institutit të konkursit të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë në pajtim me rregullat e shërbimit civil.
- 3.3. Inspektorati Shëndetësor harton program pune.
- 3.4. Inspektorët shëndetësor i përgjigjen Kryeinspektorit për shëndetësi.
- 3.5. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i inspektoratit bëhet me akt të veçantë nënligjor nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
- 3.6. Me qëllim të zbatimit të autorizimeve ligjore nga fushë veprimtaria e tij Inspektorati Shëndetësor bashkëpunon dhe koordinon veprimtarin e tij edhe me Inspektoratin e Punës, Inspektoratin Sanitar, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin Ujor dhe Inspektoratet tjera përkatëse, Prokuroritë, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) si dhe me Shërbimin Policor të Kosovës.

## Kryeinspektori Neni 4

- 4.1. Kryeinspektori është udhëheqës dhe përgjegjës për punën e Inspektoratit Shëndetësor.
- 4.2. Kryeinspektori siguron mbikëqyrjen e zbatimit unik të Ligjeve dhe rregulloreve brenda kompetencave të Inspektoratit.

- 4.3. Kryeinspektori mbikëqyrë ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me shkeljet ligjore.
- 4.4. Për punën e tij Kryeinspektori i përgjigjet Ministrin të Shëndetësisë.
- 4.5. Kryeinspektori për shëndetësi për punën e tij përpilon raporte mujore dhe vjetore dhe i'a paraqet Ministrin për Shëndetësi .
- 4.6. Inicion procedurën disiplinore lidhur me ushtrimin e punës së inspektorëve shëndetësor (në tekstin vijues: inspektorët) në rastet kur ata shkelin dispozitat ligjore apo kryejnë punë të paligjshme gjatë ushtrimit të detyrave të punës në kuadër të kompetencave të tij.
- 4.7. Për çdo veprim, sipas paragrafit 4.6 e informon Ministrin e Shëndetësisë dhe Sekretarin e Përhershëm.

Financimi i Veprimtarisë së Inspektoratit  
Neni 5

Ministria e Shëndetësisë financon veprimtarin e Inspektoratit Shëndetësor.

Inspektorët Shëndetësor  
Neni 6

Inspektorët shëndetësor ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtim me nenin 2 të këtij ligji si dhe mbikëqyrin:

- a) Cilësinë e shërbimeve shëndetësore sipas lëmijve në bazë të standardeve të pranuar dhe të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;
- b) Mënyrën e pranimit, trajtimit dhe lëshimin e pacientëve nga institucionet shëndetësore;
- c) Raportet e personelit mjekësor dhe personelit ndihmës ndaj pacientëve, qytetarëve dhe vizitorëve në institucionet shëndetësore;
- d) Përshkrimin dhe mënyrën e përdorimit të barnave, afatin e përdorimit si dhe transportimin, deponimin dhe ruajtjen e barnave;
- e) Mënyrën adekuate të aplikimit të metodave për parandalim, diagnostifikim, terapi dhe rehabilitim;
- f) Mirëmbajtjen e dokumentacionit mjekësor dhe të evidencës si dhe format e raportimit në pajtim me rregullat e përcaktuara;
- g) Mënyrën e reagimit të personelit mjekësor në situata emergjente;
- h) Inspektimin e përgjithshëm–përmes së cilës do të siguron një nivel të lartë të kujdesit shëndetësor;
- i) Inspektimin tematik-me qëllim të ofroj pasqyrë të efekteve të politikës shëndetësore të Ministrisë në nivel nacional ose për pengesa specifike në kujdesin shëndetësor;
- j) Inspektimin e shëndetit publik-për gjendjen shëndetësore të popullatës në përgjithësi dhe për grupe vulnerable sipas prioriteteve të Ministrisë dhe në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik.

Përgjegjësit dhe autorizimet e inspektorëve shëndetësor  
Neni 7

- 7.1. Inspektorët shëndetësor kanë autorizimin për qasje të papenguar në inspektimin e implementimit të akteve normative të institucioneve shëndetësore.
- 7.2. Inspektori Shëndetësor hyn lirshëm në çdo kohë dhe në çdo vend pune në institucionin shëndetësor në suaza të inspektimit të tyre pa paralajmërim.
- 7.3. Inspektorët shëndetësor gjatë inspektimit mbajnë kartelat identifikuese në ushtrimin e funksionit të tyre.
- 7.4. Bënë inspektimin dhe hulumtimin e domosdoshëm për mbledhjen e provave që konsiderohen të rëndësishme për të siguruar se dispozitat ligjore nga ana e institucioneve shëndetësore janë duke u zbatuar.
- 7.5. Inspektorët me rastin inspektimit janë të autorizuar për të bërë pyetje punëtorëve dhe personelit shëndetësor, vetëm ose në praninë e punëtorëve shëndetësor dhe dëshmitarëve të tjerë prezent.
- 7.6. Inspekton aplikimin e masave nga institucionet shëndetësore me qëllim të evitimit të kërcënimit për shëndetin e pacientëve.
- 7.7. Kërkon të përmirësohen dhe mënjanoohen pengesat në afat të caktuar të cilat mund të paraqesin shkelje të dispozitave ligjore.
- 7.8. Bënë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumentet të cilat duhet t'i mbaj institucioni shëndetësor.
- 7.9. Inspektori ka autorizim të kopjoj ekstrakte nga regjistrat dhe dokumentacioni t'i konfiskoj në raste nevojë të dëshmisë në prani të personelit apo dëshmitarëve, duke hartuar procesverbalin mbi konfiskimin e materialeve të marrura nga institucioni shëndetësor i caktuar, duke i'u përmbajtur rregullave (apo akteve nënligjore) të parapara për ruajtjen e fshehtësisë së pacientit dhe institucionit.
- 7.10. Ndalon përkohësisht veprimtarin e institucionit shëndetësor.
- 7.11. Ndalon plotësisht veprimtarin e caktuar apo pjesërisht të institucionit shëndetësor deri në plotësimin e kushteve ligjore.
- 7.12. Urdhëron zbatimin e masave konkrete brenda afatit të caktuar ligjor
- 7.13. Urdhëron masa të tjera të nevojshme për zbatimin e ligjit apo akteve tjera nënligjore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë.
- 7.14. Parashtron flet-denoncim për shkelje të rënda të ligjit për ngritjen e procedurës penale në gjykatën kompetente, kundër personit fizik dhe juridik.
- 7.15. Gjatë inspektimit, inspektorin mund ta shoqërojnë edhe personeli i institucionit shëndetësor.
- 7.16. Me rastin e inspektimit, inspektorët duhet të ruajnë fshehtësinë e subjekteve të inspektuara si dhe interesat e personave të tretë.
- 7.17. Inspektorët shëndetësor në pajtim me nenin 119, të Ligjit për Shëndetësi ndëshkojnë në rastet kur shkelen dispozitat e këtij Ligji.

Ushtrimi i punës së Inspektorit Shëndetësor  
Neni 8

8.1. Funksionin e Inspektorit Shëndetësor kanë të drejtë ta ushtrojnë, personi i cili ka të kryer fakultetin e mjekësisë, farmacisë apo stomatologjisë si dhe të jetë i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, të ketë të dhanë provimin për inspektor dhe të ketë përvojë pune së paku pesë vite në lëmin përkatëse shëndetësore.

8.2. Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nuk mund ta bëjnë punëtorët me kualifikim më të ulët profesional se sa punëtori që është subjekt i mbikëqyrjes.

8.3. Provimin për inspektorë shëndetësor e organizon Ministria e Shëndetësisë.

Neni 9

9.1. Inspektorati Shëndetësor për çështje që kërkojnë njohuri dhe eksperiencë më të gjatë profesionale mund të angazhoj ekspert të pavarur të lëmin përkatëse.

9.2. Për inspektimin sipas nenit 6.1, a), Inspektorati Shëndetësor angazhon detyrimisht ekspertin e lëmisë që është objekt i inspektimit.

Ndalimi i punës së Inspektorit shëndetësor  
Neni 10

10.1. Nëse konstatohet se gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes janë keqpërdor autorizimet ligjore respektivisht inspektori shëndetësor është ndërlidhur në procesin afarist të ndonjë institucioni shëndetësor apo është në lidhje gjaku me ndonjërin prej personelit udhëheqës të këtij institucioni, Kryeinspektori shëndetësor ia ndalon ushtrimin e funksionit inspektorit shëndetësor.

10.2. Inspektorit shëndetësor mund të i ndalohet ushtrimi i këtij funksioni edhe me vendimin gjyqësor.

10.3. Përveç ndalimit të ushtrimit të funksionit të Inspektorit shëndetësor, kundër Inspektorit mund të zhvillohet edhe procedura disiplinore në pajtim me dispozitat mbi shërbimin civil të Kosovë.

Procedura sipas ankesës  
Neni 11

11.1. Kundër vendimit të Inspektorit shëndetësor, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit mund të i bëhet ankesë Inspektoratit shëndetësor.

11.2. Inspektorati shëndetësor, është i obliguar që në afat prej 30 ditësh, të vendosë sipas ankesës të ushtruar në vendimin e inspektorit shëndetësor.

11.3. Kundër vendimit përfundimtar të Inspektoratit shëndetësor mund të ngritët kontest administrative në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.

11.4. Ankesa e ushtruar në vendimin e inspektorit shëndetësor nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Dispozitat kalimtare  
Neni 12

Më qëllim të zbatimit të këtij Ligji Ministria e Shëndetësisë nxjerr akte nënligjore më së voni 6 muaj pas shpalljes së këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj shfuqizon çdo ligj tjetër apo dispozitat tjera që janë në kundërshtim me të.

Neni 14

Ky Ligj hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-38**  
**19 janar 2006**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**akademik Nexhat Daci**